



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Integrimin European*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 07.02.2018, ora 10:15

**Drejton mbledhjen:**

**Genc Pollo – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Miratimi i kalendarit të Komisionit të Integritimit European për periudhën 5 shkurt - 23 shkurt 2018.

**Marrin pjesë:**

Genc Pollo, Bledar Cuci, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Sadri Abazi, Grida Duma, Vangjel Dule, Fatmir Velaj, Taulant Balla, Jorida Tabaku, Klajda Gjasha.

**Mungojnë:**

Monika Kryemadhi, Elisa Spiropali, Aldo Bumci, Viktor Tushaj

## HAPET MBLEDHJA

**Genc Pollo** – Sot kemi mbledhjen e parë të komisionit tonë dhe, siç do mbledhje të parë, përveç fjalëve të mira, urimeve e të dëshirave, kemi për të miratuar edhe kalendarin, i cili parashikon çështjet që i kemi diskutuar në muajt nëntor dhe dhjetor, tri seanca dëgjimore, me ministren e Drejtësisë, me ministrin e Brendshëm dhe me zëvendëskryeministren, sepse ajo mbulon administratën publike. Në kalendar kemi, gjithashtu, projektligjin “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, për të cilin ne jemi komision për dhënie mendimi.

Datat e dëgjesave janë indikative, sepse më saktë do të vendosen në bazë të komunikimit që do të kemi me të ftuarit. Ndërkohë që projektligji është parashikuar në kalendarin e Kuvendit dhe ne do të japim mendimin për përputhjen e tij me *acquis communautaire* dhe do t’ia paraqesim komisionit përgjegjës.

Besoj se në përgjithësi mund të biem dakord me atë që është propozuar dhe u është shpërndarë juve javën e kaluar. Ne thjesht duhet të caktojmë dy relatorë, një nga maxhoranca dhe një nga opozita për projektligjin “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Nga maxhoranca do të jetë zoti Velaj, kurse nga opozita ndoshta do të jetë zonja Duma. A keni ndonjë vërejtje, sugjerim apo shtesë për datën?

Zonja Tabaku.

**Jorida Tabaku** – Besoj se do të biem dakord për datat, sepse kemi një komitet të përbashkët që është në këto data.

**Genc Pollo** – Datat janë indikative, sepse nuk mund të jenë ndryshe.

**Jorida Tabaku** – Unë kam një sugjerim. Dje është publikuar Strategjia e Zgjerimit. Besoj se ne si komision, edhe në bazë të sugjerimeve që janë vendosur në Strategji, kemi detyrë parësore të ushtrojmë rolin tonë monitorues dhe kontrollues, në rast se qeveria shqiptare do të ketë një plan veprimi deri në prill për zbatimin e kësaj Strategjie. Strategjia kishte një detyrë të qartë për rritjen dhe përmirësimin e funksionit që ka parlamenti në procesin e integritit, në mënyrë të veçantë për opozitën, sepse qeverisë i takon ta përfshijë opozitën në këtë proces. Sigurisht, opozita nuk mund të përfshihet në qoftë se ka mungesë vullneti. Besoj se, në kuadër të raportimit që do të kenë ministrat, sipas prioriteteve, ne duhet të fokusohemi te detyrat dhe te prioritetet e vendosura në Strategjinë e Zgjerimit. Ka detyra të qarta, është një mundësi konkrete dhe, ashtu siç thuhet në Strategjinë e Zgjerimit, është në dorë të autoriteteve dhe në këtë rast autoriteti është qeveria

shqiptare. Kështu që unë besoj se gjatë këtyre tri javëve ne duhet të fokusohemi te ky raport që ju bashkë me zëvendëskryetarin dhe me sekretarin keni paraqitur për Komisionin e Integritimit, njëkohësisht të thërrasim edhe ministrin e Jashtëm për të na dhënë një sqarim se cili do të jetë plani i veprimit të qeverisë shqiptare nga tani dhe deri në prill për të parë se si mund të rritet roli kontrollues, monitorues i Komisionit të Integritimit, por edhe i Këshillit Kombëtar të Integritimit, duke pasur parasysh detyrat që do të ketë parlament nga tani e tutje.

**Genc Pollo** – Faleminderit, zonja Tabaku!

Kjo ishte një ndërhyrje me shumë vend. Strategjia është prezantuar dhe duhet të përfshihet në kalendarin tonë në mënyrë të përshtatshme dhe brenda afateve të duhura. Pasi të miratojmë kalendarin, do t'ju sjellim propozimin për të përfshirë Strategjinë e Komisionit Europian dhe përgjegjësitë që dalin për komisionin tonë. Ju kujtoj që ka ardhur edhe raporti i qeverisë për punën e bërë për integrimin europian, sepse është një detyrim ligjor. Ky raport është shpërndarë dhe duhet të përfshihet në punën e komisionit tonë. Pra, kemi dy materiale mbi bazën e të cilave duhet të ndërtojmë një kalendar plotësues.

Lidhur me ftesën për ministrin përgjegjës për Bashkimin Europian, kemi shkëmbyer letra për të ardhur në Këshillin Kombëtar të Integritimit Europian, ku janë të ftuar të gjithë anëtarët e këtij komisioni. Në varësi të rrethanave, pastaj mund të kemi një dëgjese tjetër, sidomos për çështje që kanë dalë nga Strategjia, për të cilën do të vendosim më vonë. Gjithsesi, edhe ajo në një formë ose në një tjetër është e përfshirë. Kështu që besoj se të gjithë kolegët bien dakord që të gjitha këto që u thanë të përfshihen në axhendën e punës së komisionit.

Zoti Çuçi.

**Bledar Çuçi** – Jemi absolutisht dakord. Ndoshta puna e komisionit filloi të materializohet më tepër pas raportit të fundit që erdhi nga Brukseli. Kështu që mendoj se, në qoftë se ka një gjë që ky komision që duhet ta bëjë më përgjegjshmëri të lartë, është pikërisht monitorimi i ecurisë së gjithë rrugëtimit të Shqipërisë drejt BE-së. Jam shumë dakord edhe me propozimin e bërë nga kolegja. Mendoj se duhet lënë një kohë e arsyeshme që ministri i Jashtëm të vijë pasi të ketë përfunduar edhe strategjia që do të përgatisë qeveria në funksion të raportit të fundit. Kështu që jam shumë dakord që monitorimin ta fillojmë që në momentin e parë të miratimit të kësaj strategjie, pra i thërrasim që ditën e parë për atë gjë dhe në vazhdim deri në qershor, kur ka një ditë që mund të merret një vendim pozitiv dhe unë jam i bindur se do të merret një vendim pozitiv nga Brukseli për Shqipërinë. Sugjeroj që ne si kryesi e komisionit ta diskutojmë nga ana praktike datën.

**Genc Pollo** – Nga ana praktike, sugjeroj që çdo anëtar të dërgojë në mënyrë konkrete me *email* propozime, të cilat do t'i shqyrtojmë në një nga mbledhjet e ardhshme të komisionit në ditët apo javët në vijim.

Biem dakord me kalendarin siç është paraqitur.

Nëse nuk keni gjë tjetër për të shtuar, ju falënderoj!

## **MBYLLET MBLEDHJA**